

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT Z.SELIM KRYEZIU

07/22/2020

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 16.7.2020, për subjektin e rivlerësimit, z. Selim Kryeziu bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, në datën 22.7.2020, vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Selim Kryeziu, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Valbona Sanxhaktari, znj. Etleda Çiftja relatores, znj. Xhensila Pine anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.